

RAPORT PËRMBLEDHËS I MONITORIMIT
PARAJA PUBLIKE SI “PARET E BABËS”

Korrik 2014, Prizren

PËRMBAJTJE

I. Përmbledhje Ekzekutive	2
II. Të gjeturat e Auditorit në Komunën e Prizrenit	3
III. Të gjeturat e Auditorit në Komunën e Prishtinës.....	4
IV. Të gjeturat e Auditorit në Komunën e Mamushës	5
V. Konstatime të përgjithshme mbi transparencën	6
VI. Të gjeturat specifike të monitorimit	7
VII. Rekomandime	8
VIII. Aktivitetet/raportimi	10
IX. Ndikimi i projektit	11
X. Për projektin dhe nevojën e monitorimit të transparencës komunale.....	12
EC Ma Ndryshe	14

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës”, i përkrahur financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.



British Embassy
Pristina

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren ~ Rr. Perandori Dioklecian 14, Kati V, 10000/Prishtinë

www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 038-224-967 & 029-222-771

I. Përmbledhje ekzekutive

Raporti i titulluar "Paraja publike si 'paret e babës'" përfshin punën katër mujore (prill-korrik) të OJQ-së "EC Ma Ndryshe" në monitorimin e transparencës në komunat e Prizrenit, Prishtinës dhe Mamushës. Kjo analizë është përgatitur në kuadër të projektit "Transparenca online e komunave të Prizrenit, Prishtinës dhe Mamushës" dhe përfshin të gjeturat që lidhen me dikastere të ndryshme të këtyre qeverive lokale, me një vështrim të veçantë në mënyrën e menaxhimit të buxhetit komunal, si element thelbësor për qeverisje të përgjegjshme dhe llogaridhënese në përputhje me besimin e marrë nga qytetarët.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë publikuar raportet e Auditorit të Përgjithshëm mbi pasqyrat financiare të vitit 2013 të këtyre tri komunave, në të cilat dokumente shpërfaqen defekte të shumta në administrimin e parasë publike, duke nisur nga mosrespektimi i dispozitave ligjore e deri te injorimi i rekomandimeve paraprake të Auditorit.

Vlerësimet që kanë dalë nga këto raporte, por edhe vështrimet e bëra gjatë një periudhe më të gjatë të monitorimit të punës së pushteteve lokale në Prizren, Prishtinë e Mamushë çojnë drejt konstatimit se zyrtarët komunal nuk kanë treguar ndjeshmëri të duhur për menaxhimin e mirë të parasë publike dhe se në raste të caktuara paratë e komunës i kanë trajtuar si "paret e babës".

Fushat si prokurimi, realizimi i buxhetit, inkasimi i të hyrave, subvencionet dhe transferet si dhe evidentimi i pasurive jofinanciare mbeten sfida të paadresuara nga komunat e lartcekura. Mungesa e transparencën në menaxhimin e buxhetit komunal ka bërë që këto probleme të trashëgohen nga viti në vit.

Gjatë periudhës raportuese monitoruesit e transparencës së qeverisë komunale janë përqendruar edhe në hulumtimin e çështjeve nga dikasterë të ndryshëm të komunës së Prizrenit dhe të Mamushës, derisa në Prishtinë monitorimi është përqendruar në transparencën e drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dhe në të tria komunat janë gjetur shkelje ligjore apo lëshime të ndryshme procedurale, që duhet të evitohen në mënyrë që qeverisja të realizohet sipas dispozitave ligjore dhe standardeve demokratike.

Rekomandimet e përgjithshme (transparenca):

- Zbatimi i Udhëzimit Administrativ 2008/09 i MAPL-së,
- Ekzekutivi lokal të raportoj më shpesh në media për çështjet publike,
- Kryetari, drejtorët dhe shefi i Zyrës për Informim të mbajnë konferenca periodike të shtypit
- Të amendamentohet Rregullorja për Transparencë,
- Zyra për Informim të fuqizohet me personel dhe të bëj përditësimin e ueb-faqes zyrtare të komunës,
- Të zbatohen në përpikëri dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike,
- Ueb faqet zyrtare të përditësohen me përmbajtje në të gjitha gjuhët zyrtare

Rekomandimet specifike (sektoriale)

a) Prizren

- Të zbatohen të gjitha rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm
- Të respektohet e drejta e qytetarëve për peticion

- Të zbatohen rekomandimet që vijnë nga organizatat e shoqërisë civile
- Komuna të ndalë rrezikimin e rajonit të burimit të Lumëbardhit

b) Prishtinë

- Të zbatohen të gjitha rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm
- Të plotësohet dhe zbatohet metodologjia e hartëzimit të ndërtimeve pa leje
- Të sigurohet zbatimi me përpikëri i ligjit për legalizime sa i përket zonave të mbrojtura
- Institucionet të reagojnë shpejtë për të siguruar mjetet e nevojshme për përfundimin e projektit të Xhamisë së Çarshisë

c) Mamushë

- Të zbatohen të gjitha rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

d) Ministritë

- MAPL-ja të merr masa për respektimin e mekanizmit të petitionit nga Komuna e Prizrenit;
- MMPH-ja të jetë më energjike në inspektimin e investimeve publike në Parkun Kombëtar “Sharri”;
- MMPH, MKRS dhe komunat e Kosovës kërkohet që të jenë të përpiktë në zbatimin e nenit 12 të ligjit për legalizime, i cili ndalon legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura dhe zonat e veçanta të trashëgimisë kulturore.

II. Të gjeturat e Auditorit në Komunën e Prizrenit

Në kuadër të monitorimit të punës së ekzekutivit të komunës së Prizrenit, ku përfshihen pothuajse të gjitha dikasteret, EC Ma Ndryshe qysh muaj më parë kishte paralajmëruar për dobësitë në performansën buxhetore¹. Raporti i Auditorit për vitin 2013 vetëm se i ka konfirmuar këto shqetësime duke nxjerrë në dritë defekte të shumta sa i përket menaxhimit të parasë publike.

Vlerësimi i Auditorit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka vënë në pah se në disa fusha të rëndësishme të veprimtarisë së komunës së Prizrenit ekzistojnë dobësi domethënëse. Kjo veçanërisht ka ndodhur në fushën e prokurimit, realizimin e buxhetit, inkasimin e të hyrave, subvencioneve dhe transfereve si dhe evidentimin e pasurive jofinanciare².

Në këtë raport gjithashtu theksohet se Auditori vitin e kaluar ka dhënë 16 rekomandime, prej të cilave komuna i ka adresuar tre sosh derisa të tjerat ose janë në proces ose nuk janë adresuar fare. Pastaj Pasqyrat Vjetore Financiare nuk kanë qenë të plota dhe të sakta, ndërkohë që menaxhimi i të hyrave mbetet problemi kyç për Komunën. Problem tjetër i rëndësishëm që përsëritet vit pas viti është rritja e obligimeve, ku detyrimet e papaguara në fund të 2013-ës kanë arritur shifrën mbi 4.5 milionë euro, me ç'rast 45% janë detyrimet kontigjente. Në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë janë vërejtur tejkalime në numrin e të punësuarve, që kanë sjellë vështirësi në ekzekutimin e

¹ Komunikatë, “EC Ma Ndryshe”, http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_mars_1_2014_.pdf

² ZAP, Raporti i Auditimit, http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPZ_2013_Shqip_772263.pdf

pagesave të pagave. Dobësitë sistematike ekzistojnë në fushën e prokurimit, që nga zotimi i fondeve, ndjekja e procedurave të prokurimit e deri te menaxhimi i kontratave³.

Situatë më e mirë sa i përket menaxhimit të parasë publike nuk ka as në këtë vit. Ndonëse Qeveria qendrore ka urdhëruar limitimin e shpenzimeve në kategorinë mallra dhe shërbime për 15 për qind, qeveria lokale e Prizrenit në gjysmën e parë të këtij ka shpenzuar rreth 30 për qind më shumë mjete për dreka zyrtare krahasuar me periudhën e njëjtë të 2013-ës.

Sipas raportit përmbledhës të shpenzimeve të gjashtëmujorit të parë të 2014-ës⁴ del se për dreka zyrtare janë shpenzuar afër 64 mijë euro derisa një vit më parë ishin shpenzuar mbi 46 mijë euro. Ajo që vlen të theksohet në këtë zë buxhetor është se për herë të parë Komuna ka dalë me shpjegimin se në këto shpenzime bëjnë pjesë edhe drekat që janë shtruar nga shkollat me rastin e shënimit të ditës së tyre, pastaj sektori i shëndetësisë dhe sektori i administratës. Fakti që për herë të parë janë dhënë shpjegime të tilla dëshmon mungesën e transparencës karshi publikut në raport me shpenzimet që janë bërë nga buxheti komunal. Ky defekt ka përcjellë punën e qeverisë lokale në mënyrë sistematike gjatë qeverisjes disa vjeçare.

III. Të gjeturat e Auditorit në Komunën e Prishtinës

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka publikuar raportin e auditimit edhe për komunën e

³ ZAP, Raporti i Auditimit, http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPZ_2013_Shqip_772263.pdf

⁴ Qasja në dokumente zyrtare, DEF, raporti përmbledhës i shpenzimeve të gjashtëmujorit të parë, sipas kategorive, datë 5.07.2014

Prishtinës. Auditori ka hasur në parregullsi të shumta të administratës së kaluar të Komunës së Prishtinës.

Raporti nënvizon se Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2013 i ka dhënë 418.946 euro si subvencione pa pranuar kërkesë dhe pa nënshkruar marrëveshje, pra për Kompaninë publike “Hortikultura” (300,000€), “Sport Marketing” (100,000€), dhe shoqata e grave fermere “Alba” (18,945€), derisa Marrëveshja e subvencionit për “Termokos” prej 500,000€ ishte nënshkruar dy muaj pasi iu janë dhënë të hollat.

Në raport theksohet se në pesë projekte kapitale si ndërtimi i rreth rrotullimit në dalje të Prishtinës - drejtimi i Veternikut, Sheshi i Pavarësisë - Ibrahim Rugova dhe Sheshi Zahir Pajaziti, Rindërtimi i rrugëve në lagjen Mati, grupi II, ndërtimi i rrugës “Malush Kosova” dhe mbikalimi të shkallët në lagjen “Arbëria,” kishte vonesa në ekzekutimin e punëve. Për më tepër, Komuna nuk kishte aplikuar ndëshkimet që ishin në dispozitat kontraktuale.

Pastaj projekti për ndërtimin e shkollës fillore në Lagjen Arbëria, bazuar në kontratën e datës 30.12.2009 prej 656,948€, ishte ndërprerë në vitin 2012 për shkak të kontestit pronësor, pasi ishin paguar 420,000€. Në fillim të vitit 2013 është nënshkruar një kontratë e re në vlerë 737,832€, por pas pagesës së situacionit të parë prej 47,143€ ishin ndërprerë punimet për shkak të motit të keq dhe më pastaj Gjykata Themelore e Prishtinës ka caktuar masën e ndalimit të kryerjes së punimeve për shkak të kontestit pronësor. Një kompensim prej gjithsej 200,000€ është pretenduar nga pronari i tokës. Tani ky projekt ka mbetur, pezull përkundër pagesave prej 467,143€.

Tejkalimi i numrit të punëtorëve është një tjetër element i parregullt që përfshihet në raport. Rreth 80 të punësuar ishin më shumë në sektorin e Arsimit (3257 kundrejt 3181). Të gjithë këta të punësuar janë prezantuar si të punësuar me orar të plotë. Te arsimit mesëm ishin të lejuar 832, ndërsa të punësuar janë 878, te arsimit fillor 2052, ndërsa janë të punësuar 2083 dhe te çerdhet 273, ndërsa janë 276 të punësuar. Kurse, 13 punëtorë u paguan nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, pagesë kjo që është në kundërshtim me Ligjin e Shërbyesve Civil⁵.

Auditori në vitin 2012 ka paraqitur 17 rekomandime kryesore për komunën e Prishtinës, me ç'rast dy rekomandime janë adresuar plotësisht, tri janë adresuar pjesërisht dhe dymbëdhjetë tjera nuk janë adresuar ende.

Ndërkohë kryetari i kësaj komune, Shpend Ahmeti ka dhënë një zotim publik se me auditorin do të hartohet një plan që gabimet dhe shkeljet e viteve të kaluara të mos përsëriten më⁶ në komunën e Prishtinës.

IV. Të gjeturat e Auditorit në Komunën e Mamushës

Konkluzioni i përgjithshëm i Auditorit është se administrimi dhe raportimi financiar brenda komunës së Mamushës vazhdon që të përballet me dobësi marrë parasysh faktin se qeveria komunale nuk i ka zbatuar rekomandimet e mëhershme të ZAP-it. Komuna e Mamushës nuk i ka adresuar rekomandimet e Auditorit nga vitet e shkuara dhe nuk ka ndërtuar një proces

të fortë që do të siguronte zbatimin e plotë dhe në kohë të këtyre rekomandimeve tona⁷

Ky autoritet shtetëror ka konstatuar se gjatë viteve të fundit, komuna e Mamushës ka adresuar vetëm pjesërisht rekomandimet e ZAP-it lidhur me nenin 16 - Shpalojsja e pasurive dhe pagesat nga palët e treta - dhe rrjedhimisht kjo fushë vazhdon të paraqesë një rrezik domethënës, pasi si pasojë e natyrës së regjistrimeve bazë dhe mungesës së dokumenteve mbështetës ekzistojnë disa pasiguri lidhur me të drejtat e pronësisë, plotësinë dhe vlerësimin e pasurive, objekteve dhe pajisjeve.

ZAP prej vitesh tërheq vërejtjen se komuna ende nuk ka një sistem automatik faturimi për të gjitha llojet e të hyrave vetanake dhe llogarive të arkëtueshme lidhur me to, ndërkohë që edhe ekzekutimi i buxhetit mbetet një nga fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime.

Auditori po ashtu ka nënvizuar se mospajtimet e identifikuar në prokurime lidhen me klasifikimet e gabuara të shpenzimeve dhe në tejkalimin e buxhetit për to. Si një shqetësim tjetër paraqitet edhe mos krijimi i një Departamenti të Auditit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditit, që po ashtu është rekomandim që përsëritet vit pas viti nga ZAP-i.

Në raportin e fundit, ZAP konstaton se komuna e Mamushës nuk e ka zbatuar asnjërin prej 9 rekomandimeve të dhëna për vitin financiar 2012, përderisa prej 11 rekomandimeve të dhëna për vitin 2011, vetëm 1 është zgjidhur dhe 3 pjesërisht janë zgjidhur. Ndërkohë prej 6 rekomandimeve të dhëna për vitin financiar

⁵ZAP, Raporti i Auditimit, http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPR_2013_Shqip_77141.pdf

⁶Postim në media sociale, https://www.facebook.com/shpend.ahmeti?fref=ts&ref=br_tf

⁷ZAP, Raporti i Auditimit, http://oag-rks.org/repository/docs/3_Report_Mamushe_13_ALB_FINISHED_READY_FOR_PRINT_876199.pdf

2010 komuna ka adresuar vetëm një në tërësi dhe një tjetër pjesërisht, duke injoruar 4 të tjera.

V. Konstatime të përgjithshme mbi transparencën

Transparenca luan rol të veçantë në përmirësimin e qeverisjes dhe luftimin e korrupsionit, kryesisht nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve, forcimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile në arenën publike dhe nxitjen e llogaridhënies më të hapur nga zyrtarët publik. Transparenca shërben si mjet për të krijuar dhe siguruar qytetari të informuar me qëllim që kufijtë e përgjegjësisë dhe veprimet e zyrtarëve të jenë të dukshme dhe në këtë mënyrë llogaridhënëse. Transparenca, pra mbetet një nga shtyllat kryesore të qeverisjes së mirë, meqë sistemet e mbyllura që përshkruhen me sjellje diskrete ofrojnë hapësirë për dyshime në lidhje me veprimet korruptive.

Që prej fillimit të monitorimit, EC Ma Ndryshe shpesh herë ka theksuar se transparenca e pushtetit lokal ka të meta strukturore dhe se përkundër përpjekjeve modeste të lidershit komunal ajo vazhdon të jetë në nivel të ultë, që manifestohet me informim jo-adekuat, mos përfshirje të duhur në vendimmarrje dhe mungesë të llogaridhënies kundruall qytetarëve.

Në këtë pikëpamje gjatë muajve të fundit ka një përparim cilësor në komunën e Prishtinës, ku lidershipi komunal ka një komunikim më të shpeshtë me publikun dhe dialog me shoqërinë civile, jo vetëm në mënyrë konvencionale, por edhe duke i futur në përdorim mediat sociale.

Për dallim prej Prishtinës, qeveria komunale e Prizrenit ka qenë më hezituese në këtë drejtim. Për shkak të ngurtësisë së ekzekutivit të

Prizrenit për të qenë transparent përballë shoqërisë civile dhe medieeve, këta të fundit përmes një procesi të udhëhequr nga EC Ma Ndryshe kanë krijuar “Forum Transparenca”.

Objektivat e këtij Forumi janë që të koordinojë dhe promovojë veprimet e aktivistëve të shoqërisë civile dhe gazetarëve në Prizren që janë aktiv në fushën e qeverisjes demokratike; të rrisë vizibilitetin e punës së shoqërisë civile përmes prezencës së shtuar në mediat lokale dhe qendrore; të ngrisë aftësinë avokuese të shoqërisë civile për qeverisje më transparente dhe llogaridhënëse në Prizren dhe të ngrisë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe sigurojë që kërkesat e tyre merren parasysh.

Që prej prillit Forumi ka organizuar disa debate në formatin “Ballafaqim” ku janë trajtuar Punësimet në Arsim (14 maj 2014), Ndërtimet pa leje brenda Zonës Historike të Prizrenit (1.06.2014), Transparenca në qeverisjen lokale të Prizrenit (3 korrik 2014) dhe Trajtimi i diasporës nga institucionet lokale, ndërkohë që është organizuar edhe një debat me studentë mbi Qeverisjen Demokratike (13.06.2014).

Si rezultat i angazhimit të Forumit që prej muajit korrik kryetari i komunës së Prizrenit, Ramadan Muja ka hapur takimet formale që mban me drejtorët e tij për mediat dhe shoqërinë civile.

Hapja e takimeve formale është vetëm një hap që duhet të pasohet edhe me veprime tjera për të siguruar transparencë të nevojshme për vendimmarrjen komunale.

Ndërsa në komunën e Mamushës përkundër përpjekjeve të deritanishme niveli i transparencës nuk është në nivelin e dëshiruar, gjë që ndikohet edhe nga kapacitetet e

kufizuara të burimeve njerëzore brenda pushtetit lokal. Qeveria komunale ka para vetes një shteg të gjatë deri te komunikimi i mirëfilltë me publikun mbi vendimmarrjen dhe llogaridhënien.

VI. Të gjeturat specifike të monitorimit

Gjatë periudhës raportuese monitoruesit e transparencës së qeverisë komunale janë përqendruar në hulumtimin e çështjeve nga dikasterë të ndryshëm të komunës së Prizrenit dhe të Mamushës, derisa në Prishtinë monitorimi është përqendruar në transparencën e drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

a) Të gjeturat specifike të monitorimit në Prizren

DUPH nuk lëshon leje por DSHP lejon vendosjen e lojërave – EC Ma Ndryshe ka adresuar çështjen e vendosjes së lojërave (Luna Parkut) në afërsi të Qendrës Sportive “Sezai Surroi” në Prizren, pas ankesave që ka pranuar nga banorët që jetojnë në lagjet përreth. Qytetarët e këtyre lagjeve, pas paraqitjes verbale të ankesave, me mbështetjen e marrë nga monitoruesit kanë iniciuar mbledhjen e nënshkrimeve me anë të cilit peticion nga vendimmarrësit komunal kanë kërkuar ndalimin e vendosjes së lojërave në brendi dhe afërsi të Qendrës Sportive, pasi që pakënaqësia e tyre në këtë drejtim ishte anashkaluar për vite me radhë. Peticioni me 82 nënshkrime të banorëve nuk është shqyrtuar nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit. Ndërkaq lojërat në fillim të prillit janë vendosur përsëri në parkingun përballë Qendrës Sportive, me leje të autoriteteve komunale. Pas insistimit të EC Ma Ndryshe për të marrë informata në lidhje me fatin e peticionit të dorëzuar, DSHP-ja (Drejtoria e Shërbimeve Publike) më 14 prill 2014 ka

njoftuar se ky organ ka lëshuar leje për vendosjen e parkut të lojërave. Ndërkaq DUPH-ja (Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor) më 18 prill 2014 ka njoftuar se nuk ka lëshuar leje për vendosjen e këtyre lojërave dhe ka sqaruar se ato “janë pa leje”. Kjo drejtori ka theksuar se edhe nëse do të ketë kërkesa për pajisje me leje ato do të refuzohen.

Komuna me bilanc negativ në zbatimin e rekomandimeve – Gjatë vitit 2013 dhe në katër muajt e parë të 2014-ës në kuadër të monitorimit të transparencës së Qeverisë Komunale të Prizrenit, EC Ma Ndryshe ka publikuar të gjeturat e hulumtimeve të ndryshme dhe së bashku me to ka ofruar edhe rekomandime për përmirësimin e gjendjes në dikastere të caktuara. Gjithashtu ka reaguar edhe ndaj çështjeve të ndjeshme duke kërkuar veprim adekuat nga përgjegjësit e komunës së Prizrenit. Brenda kësaj periudhe qeveria lokale ka ndërmarrë disa veprime në drejtim të zbatimit të disa rekomandimeve, që megjithatë duhet të përcillen me hapa të mëtutjeshëm, në mënyrë që të ketë përmirësim të standardeve të qeverisjes së mirë dhe demokratike. Krahas kësaj, ka pas edhe raste kur ekzekutivi komunal i ka injoruar propozimet që kanë ardhur nga shoqëria civile, duke bërë që ndërtimi i partneritetit ndër-sektorial të mbetet ende vetëm një objektiv i dëshiruar.

Rajoni i burimit të Lumëbardhit rrezikohet nga Komuna e Prizrenit - EC Ma Ndryshe gjatë muajve maj-qershor ka hulumtuar çështjen e punimeve infrastrukturore të ndërmarrë nga komuna e Prizrenit në zonën e parë të rajonit të burimit të Lumëbardhit, që është pjesë e Parkut Kombëtar “Sharri”. Në bazë të informatave që monitoruesit kanë siguruar nga njohësit e kësaj fushe del se Komuna e Prizrenit i ka nisur punimet në mënyrë të jashtëligjshme në zonën

e Parkut Kombëtar “Sharri”, sepse pa u pajisur me lejet e pëlqimet paraprake të institucioneve kompetente ka filluar projektin për marrjen e ujit nga Rajoni i burimit të Lumëbardhit, në zonën e Prevallës të PK Sharri. Konkretisht, sipas ekspertëve, kryerja e punimeve ka nisur të bëhet pa pëlqim mjedisor, pa leje ujore nga MMPH-ja dhe pa Vlerësim të Ndikimit në Mjedis. Ata kanë vlerësuar se në këtë rast Komuna e Prizrenit ka bërë shkelje të ligjeve që kanë të bëjnë me Parkun Kombëtar Sharri, atë të Natyrës, Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, etj.

b) Të gjeturat specifike të monitorimit në Prishtinë

Identifikimi dhe regjistrimi i ndërtimeve pa leje – EC Ma Ndryshe, në muajt e parë të këtij viti, ka hartuar dhe testuar një metodologji për evidentimin dhe hartëzimin e ndërtimeve pa leje. Objektivat kryesore të kësaj metodologjie ishin skanimi i ndërtimeve në terren, identifikimi dhe regjistrimi i shkeljeve dhe paraqitja e shtrirjes së tyre në mënyrë grafike në hartë. Qëllimi i këtij evidentimi është bërja publike e shkeljeve ndërtimore në qytetin e Prishtinës por edhe rritja e nivelit të transparencës së Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës. Testimi i metodologjisë u krye në Lagjen Pejton të qytetit të Prishtinës, ndërsa të dhënat e tjera u mblodhën pjesërisht përmes kërkesave për qasje në dokumente publike në drejtoritë përkatëse në komunën e Prishtinës.

Trajtimi i ndërtimeve pa leje përbrenda zonave të mbrojtura - EC Ma Ndryshe e punoi një hartë, në të cilën paraqiten të gjitha ndërtesat në qytetin e Prishtinës që janë në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohëshme, si dhe perimetri prej 50 metrash që përbën zonat e mbrojtura rreth atyre ndërtimeve. MMPH, MKRS dhe komunat e

Kosovës tani duhet të jenë të përpiktë në zbatimin e nenit 12 të ligjit për legalizime, i cili ndalon legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura dhe zonat e veçanta të trashëgimisë kulturore.

As këtë vit nuk përfundon restaurimi i Xhamisë së Çarshisë në Prishtinë - Projekti i konservimit dhe restaurimit të Xhamisë së Çarshisë filloi në vitin 2011 dhe deri më tani Komuna ka ndarë 562 mijë euro për realizimin e këtij projekti. Që nga viti 2011 deri në vitin 2013 është kryer një pjesë e punimeve, mirëpo me vonesa të theksuara, për shkak të pagesave jo të rregullta nga ana e Komunës, siç thotë IMMK. Edhe pse punimet ishin paraparë të përfundojnë në vitin 2013, ato nuk kanë përfunduar ende. Sipas IMMK-së, për përfundimin e projektit nevojiten edhe rreth 95.000 euro, meqë Komuna nuk ka llogaritur koston e projektit, por vetëm koston e punimeve. Për këtë, IMMK ka bërë kërkesë në komunë mirëpo në buxhetin e vitit 2014 komuna e Prishtinës nuk ka paraparë ndonjë shumë për këtë Xhami meqë projektin e ka konsideruar të kryer. E, nëse Xhamia nuk arrin të përfundohet as këtë vit, IMMK thotë se vlera prej 95.000 euro me të cilat mund të përfundoj sivjet projekti, vitin tjetër, për shkak të dëmtimeve që mund t'i ketë Xhamia, mund të rritet.

VI. Rekomandime

Rekomandime të përgjithshme (transparenca)

Për të adresuar të metat e përgjithshme sa i përket transparencës së qeverive komunale në Prizren, Mamushë e Prishtinë rekomandojmë që:

- Qeveria Komunale të zbatoj në përpikëri dispozitat e Udhëzimit Administrativ 2008/09 të MAPL-së për transparencë,

- Ekzekutivi lokal të raportoj më shpesh në media për çështjet që lidhen me përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin urban, investimet, të hyrat komunale dhe çështje tjera,
- Kryetari, drejtorët dhe shefi i Zyrës për Informim të mbajnë konferenca periodike të shtypit, por edhe të organizojnë seanca të pyetje-përgjigjeve me publikun e gjerë ose grupet e interesit,
- Të amendamentohet Rregullorja për Transparencë dhe të përfshihen në mënyrë eksplicite obligimet e kryetarit dhe ekzekutivit komunal në raport me transparencën lokale,
- Zyra për Informim të fuqizohet me personel dhe të bëjë përditësimin e ueb-faqes zyrtare të komunës me informacione relevante për qytetarët,
- Të zbatohen në përpikëri dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike,
- Ueb faqet zyrtare të përditësohen me përmbajtje në të gjitha gjuhët zyrtare

Rekomandime specifike (sektoriale)

Në bazë të të gjeturave të deritanishme në sektorët specifik të qeverisjes lokale, EC Ma Ndryshe rekomandon ndërmarrjen e një numri veprimesh për të përmirësuar praktikatat e veprimit, vendimmarrjes dhe zbatimit të projekteve nga qeveritë komunale në Prizren, Prishtinë e Mamushë.

Të zbatohen të gjitha rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm – Ekzekutivët komunalë duhet të tregojnë përkushtim shumë më të lartë për zbatimin e rekomandimeve të dala nga raportet e auditimit; Nevojiten përpjekje serioze të qeverive komunale për përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha fushat e identifikuar nga

ZAP-i; Të përmirësohen standardet e qeverisjes së parasë publike; dhe kuvendarët e KK-së duhet të ushtrojnë kontroll dhe mbikëqyrje të shpenzimeve të buxheteve komunale.

Rekomandimet tjera specifike për:

a) Komunën e Prizrenit

Të respektohet e drejta e qytetarëve për peticion – Komuna e Prizrenit duhet që të: dëgjoj me vëmendje shqetësimet e qytetarëve dhe të veproj urgjentisht me qëllim të krijimit të një ambienti më të mirë jetësor për ta, në secilin rast; të zbatoj dispozitat e LVL-së, Statutit të Komunës së Prizrenit dhe Rregullores për Transparencë mbi “Peticionet” dhe të respektoj të drejtën e qytetarëve për adresim të çështjeve me anë të peticionit; Koordinoj punët mes drejtorive gjatë shqyrtimit të kërkesave për leje për shfrytëzimin e hapësirës publike dhe të inspektoj respektimin e kritereve të përcaktuara në lejen e lëshuar nga DSHP-ja për “Luna Parkun” në dhe rreth Qendrës Sportive.

Të zbatohen rekomandimet që vijnë nga organizatat e shoqërisë civile – Në Prizren tashmë është krijuar tradita disa vjeçare e monitorimit të punës së organeve komunale nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat pothuajse në baza mujore kanë raportuar për defekte apo shkelje të ndryshme në vendimmarrje. Ato kanë ofruar rekomandime të ndryshme për evitimin e këtyre defekteve, të cilat në të shumtën e rasteve janë injoruar nga lidershipi komunal. Komuna duhet të tregoj një përkushtim më të madh për zbatimin e rekomandimeve të OSHC-ve.

Komuna të ndalë rrezikimin e rajonit të burimit të Lumëbardhit – Ekzekutivi lokal duhet të ndalë të gjitha punimet derisa të pajiset me pëlqimet

dhe lejet e nevojshme për intervenim në rajonin e burimit të Lumbardhit; të ndalojë praktikën e fillimit të punimeve pa u pajisur me leje, pëlqime dhe vlerësime përkatëse të institucioneve përgjegjëse; gjatë hartimit të projekteve investuese të koordinohet me të gjitha institucionet relevante të fushës ku intervenohet, në mënyrë që investimet publike të sjellin vlerë të shtuar dhe jo dëmtim apo rrezikim të burimeve dhe trashëgimisë natyrore dhe lidhur me çështjet infrastrukturore dhe mjedisore të ketë transparencë më të madhe.

b) Komunën e Prishtinës

Të plotësohet dhe zbatohet metodologjia e hartëzimit të ndërtimeve pa leje –

EC Ma Ndryshe, në muajt e parë të këtij viti, ka hartuar dhe testuar një metodologji për evidentimin dhe hartëzimin e ndërtimeve pa leje. Objektivat kryesorë të kësaj metodologjie Ishin skanimi i ndërtimeve në terren, identifikimi dhe regjistrimi i shkeljeve dhe paraqitja e shtrirjes së tyre në mënyrë grafike në hartë. Metodologjinë e hartëzimit, por edhe të dhënat e mbledhura deri më tani për lagjen pilot, EC Ma Ndryshe ia dorëzoi Drejtorisë së Urbanizmit të komunës së Prishtinës, me kërkesën për plotësime të mëtutjeshme dhe implementimin e saj.

Të sigurohet zbatimi me përpikëri i ligjit për legalizime sa i përket zonave të mbrojtura - EC Ma Ndryshe e punoi një hartë, në të cilën paraqiten të gjitha ndërtesat në qytetin e Prishtinës që janë në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohëshme, si dhe perimetri prej 50 metrash që përbën zonat e mbrojtura rreth atyre ndërtimeve. Gjatë përgatitjes së dokumentacionit të trajtimit të ndërtimeve pa leje, u rekomandojmë komunave që në koordinim të plotë me MMPH-në dhe

MKRS-në, të hartojnë harta të tilla apo të ngjashme zonale.

Institucionet të reagojnë shpejtë për të siguruar mjetet e nevojshme për përfundimin e projektit të Xhamisë së Çarshisë – Për përfundimin e projektit rekomandohet edhe bashkëpunimi dhe komunikimi i vazhdueshëm në mes institucioneve dhe palëve të përfshira në projekt, gjatë të gjitha fazave; pastaj planifikimi i detajuar i planit dinamik dhe buxhetit; dhe mbikëqyrja e rregullt e punimeve nga profesionistët e fushës.

c) Ministrinë

Rekomandohet MAPL-ja që si mbikëqyrëse e pushtetit lokal të merr masa për respektimin e mekanizmit të petitionit nga Komuna e Prizrenit.

Rekomandohet MMPH-ja që të jetë më energjike në inspektimin e investimeve publike në Parkun Kombëtar “Sharri”, me qëllim të parandalimit të shkeljeve ligjore dhe dëmtimit të natyrës.

Nga MMPH, MKRS dhe komunat e Kosovës kërkohet që të jenë të përpiktë në zbatimin e nenit 12 të ligjit për legalizime, i cili ndalon legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura dhe zonat e veçanta të trashëgimisë kulturore.

VII. Aktivitetet/raportimi

Në periudhën raportuese të projektit EC Ma Ndryshe ka ndërmarrë aktivitete të monitorimit duke përfshirë edhe avokimin dhe adresimin e shkeljeve ligjore të komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës. Monitorimi ka qenë i përqendruar në degët e ekzekutivit të komunës (kryetari i komunës dhe drejtoritë) si dhe shërbimi civil, në Prizren e Mamushë, derisa në Prishtinë është përqendruar kryesisht në drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Monitorimi është kryer përmes monitoruesve permanentë, të cilët kanë pas prezencë të rregullt në mbledhjet e qeverisë lokale, zyrat komunale dhe qasje në dokumentet zyrtare të komunës.

Të gjeturat e monitorimit janë postuar në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org. Ueb-faqja është përkthyer edhe në gjuhën angleze dhe përditësimi i përmbajtjes në të dyja gjuhët bëhet në kohë reale. Po ashtu janë lëshuar komunikatat e rregullta për media, me informata përmbledhëse të të gjeturave të monitorimit.

Gjatë kësaj periudhe kryetari i komunës së Prizrenit ka mbajtur të hapura mbledhjet e qeverisë komunale për monitoruesit e EC Ma Ndryshe, që ka publikuar njoftime përkatëse rreth vendimeve të qeverisë lokale të Prizrenit. Ndërkohë në muajin korrik këto takime janë hapur edhe për mediat dhe shoqërinë civile.

Po ashtu EC Ma Ndryshe ka realizuar kontakte me institucionet e nivelit qendror me qëllim të adresimit të kërkesave për respektim të ligjeve.

Në kuadër të angazhimeve të Forumit Transparenca janë mbajtur 3 debate “Ballafaqim”, ku drejtori i DKA-së në Prizren, Nexhat Çoçaj është përgjigjur mbi çështjet që

kanë të bëjnë me “Punësimet në Arsim” (14 maj 2014). Në debatin e radhës drejtori i Urbanizmit, Nijazi Kryeziu dhe drejtori i Inspektorateve, Bedri Bytyçi janë përballur me gazetarët e shoqërinë civile mbi trajtimin e ndërtimeve pa leje brenda Zonës Historike të Prizrenit (1 qershor 2014), ndërkohë që për Transparencën në qeverisjen lokale të Prizrenit (3 korrik 2014) ka raportuar shefi i Zyrës për Informim në komunën e Prizrenit, Ymer Berisha. Drejtori i Administratës, Ilir Baldedaj, shefi i Zyrës së Ofiçarisë, Ruzhdi Hoxha dhe zëdhënësi i Policisë në Prizren, Vesel Gashi kanë qenë panelistë të debatit mbi trajtimin që i bëhet diasporës (22 korrik 2014). Pos kësaj është organizuar edhe një debat me studentë mbi Qeverisjen Demokratike (13 qershor 2014).

Në të njëjtën kohë në bashkëpunim me Forumin Transparenca janë publikuar dy komunikata: “Kryetari t’i rihapë takimet e ekzekutivit” dhe “Ramadan Muja i vetmi kryetar i mbyllur në Kosovë”.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe, EC Ma Ndryshe ka hartuar dhe publikuar Udhëzuesin për Transparencë në komuna, që i është dorëzuar zyrtarëve përgjegjës, me qëllim të prezantimit të obligimeve dhe detyrimeve ligjore të pushtetit lokal për transparencë dhe llogaridhënie.

VIII. Ndikimi i projektit

Gjatë këtyre muajve të monitorimit të Transparencës online të komunave Prizren, Mamushë e Prishtinë janë arritur rezultatet si në vijim: 7 komunikata për shtyp në çështjet që shtrihen nga urbanizmi e deri te shërbimet publike, 1 analizë mbi transparencën komunale, publikime të vendimeve të kryetarëve të komunave në baza mujore, dy komunikata në

bashkëpunim me Forumin Transparenca dhe njoftime tjera, sikurse edhe konferenca periodike për shtyp.

Këto aktivitete janë mbuluar nga mediet (lokale dhe nacionale) sipas të dhënave në vijim: 21 kronika televizive me rreth 110 min paraqitje; gjithsejtë 17 artikuj gazetareskë me rreth 9 faqe, 45 raportime në ueb portale dhe rreth 70 minuta raportim në radio.

Projekti ka pasur ndikime të ndryshme mbi fushat që ka prekur.

Projekti ka arritur që të hap mbledhjet e qeverisë lokale, duke i ofruar publikut informata të menjëhershme mbi vendimet e marra nga ekzekutivi komunal. Në fund, projekti është bërë një pikë legjitime dhe e besueshme e qytetarëve, të cilët kanë adresuar dhe vazhdojnë që t’i paraqesin shqetësimet e tyre në raport me qeverisjen komunale.

IX. Për projektin dhe nevojën e monitorimit të transparencës komunale

Ekzekutivi i komunës, i cili tashmë udhëhiqet nga kryetari i komunës, po promovon një cilësi të re të qeverisjes lokale dhe të ofrimit të shërbimeve publike. Ndonëse ky ndryshim nuk është gjithmonë pozitiv, ekzekutivi i komunës (sidomos kryetari) po shndërrohet në adresën e vetme të përgjegjës, dhe si pasojë të llogaridhënies, në raport me qeverisjen e mirë dhe shërbimet cilësore publike. Mbikëqyrja e punës së kryetarit (sidomos pjesa e ligjshmërisë) është ndër sfidat më të mëdha të qeverisjes lokale në Kosovë.

Për këtë arsye, monitorimi dhe raportimi për aktivitetet e keq-qeverisjes (sidomos të ekzekutivit të komunës) do të duhej të ishte

detyrë primare e shoqërisë civile në raport me qeverisjen e mirë në nivel lokal.

Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës është projekt për monitorimin e punës së organeve komunale. Fokusi themelor i monitorimit është ekzekutivi i komunës (kryetari i komunës dhe drejtoritë) si dhe shërbimi civil. Monitorimi bëhet përmes monitoruesve permanentë, të cilët kenë prezencë të rregullt në zyrat komunale dhe qasje të papenguar në dokumentet zyrtare të komunës. Raportimi i të gjeturave të monitorimit përdorë gjithashtu një mekanizëm permanent, ueb-faqen e transparencës së qeverisjes lokale. Të gjeturat e monitorimit postohen drejtpërdrejtë në ueb-faqen e projektit, për të krijuar mundësi qasjeje për të gjitha palët e interesuara. Të gjeturat e monitorimit janë bazë e veprimit për nivelin e dytë të aktiviteteve të projektit, avokimin dhe adresimin e shkeljeve ligjore. EC Ma Ndryshe përdorë mundësitë ligjore për të nisur procedura të adresimit të shkeljeve ligjore nga ana e komunës.

Qëllimi themelor i projektit është forcimi i qeverisjes së mirë në komunat e Prizrenit, të Mamushës dhe të Prishtinës. Objektivat specifike që do të ndihmojnë arritjen e këtij qëllimi janë: Përmirësimi i nivelit të informimit të përgjithshëm të publikut mbi vendimmarrjen lokale, Aktivizimi i mekanizmave qeveritarë dhe gjyqësorë për adresimin e praktikave që cenojnë ligjshmërinë, Rritja e nivelit të transparencës komunale në vendimmarrje, Rritja e vigjilencës së vendimmarrësve lokalë në raport me respektimin e ligjshmërisë në qeverisjen lokale, Rritja e pjesëmarrjes së grupeve të komunitetit në vendimmarrjen lokale.

Rëndësia e ndërtimit të transparencës në nivel lokal si mjet për trajtimin e disa prej sfidave më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm dhe demokracinë është i pazëvendësueshëm. Koncepti i qeverisjes është më i gjerë se qeveria dhe kërkon përfshirje më të gjerë të komunitetit dhe organizatave të ndryshme.

Transparenca në proceset vendimmarrëse dhe në institucione ka potencial të bëhet një strategji qendrore për t'u angazhuar aktorët në luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimin e cilësisë së qeverisjes urbane në përgjithësi. Prandaj, transparenca paraqet parimin thelbësor të qeverisjes së mirë. Qasja e lirë në informata luan një rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës. Informacioni, megjithatë, duhet të jepet në kohë, të jetë relevant, i saktë dhe i plotë për t'u përdorur në mënyrë efektive. Çështjet se kush e prodhon

atë informacion, dhe për çfarë qëllimi, bëhen aspekte kyçe të transparencës, kur interesat konkurrencte konvergojnë në një çështje të veçantë. Një nga modelet më të avancuara për sigurimin e transparencës është korniza pesëpikëshe për rritjen e transparencës: 1. Vlerësim dhe monitorim, 2. Qasje në informacion, 3. Etikë dhe integritet, 4. Reformë institucionale dhe 5. Trajtimi i çështjeve specifike.

EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t’i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014-2015), Lidhja mes komunitetit dhe shërbyesve të drejtësisë (2014), Urbanism Watch - Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013 – 2014), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013 – 2014), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012 - 2014), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimtari qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Rinia dhe Transparenca: Përparim apo stagnim? (2014), Dokumentari - Sa aktiv, aq transparent? (2014), Udhëzues për Transparencën në Komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014), Qendra Historike e Prizrenit–zonë e (pa)mbrojtur (2014), Qyteti gjithëpërfshirës (2014), Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikimi Urban për Qytetarët (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Prizreni “Qytet i kulturës” - film dokumentar (2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Pesë analiza të projektit “Online Trasparency”,: 1. Një vit monitorim për më shumë transparencë 2. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 3. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 4. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 5. Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).